



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA PËRMET
KOORDINATORI PËR KONSULTIMIN PUBLIK

Nr. _____ Prot

Datë ____/____/2023

NJOFTIM

Konsultim Publik me temë : “Hartimi i Planit Social në Bashkinë Përmet 2024-2027”

Ne zbatim të ligjit nr. 146/2012 ” Per njoftimin dhe konsultimin publik” pika 1 dhe 2 neni 5, pika 1,2,3 4; Rregullores se Keshilli Bashkiak ” Per konsultimin publik”, si dhe ligjit me nr. 139/2015 ” Per veteqeverisjen vendore” neni 18 i tij,

Ju njoftojme se:

Diten e Martë ne date 25 .07 .2023 ora 11:00, ne ambientet e sallës së mbledhjeve të Këshillit Bashkiak do te organizohet seanca konsultative për nisjen e punës për **Hartimin e Planit Social 2024-2027 të Bashkisë Përmet.**

Hapat e punës për hartimin e planit social (për diskutim)

Më poshtë paraqiten hapat që do të ndërmerren me qëllim mbështetjen e bashkisë gjatë hartimit të planit social. Secili hap do të diskutohet me drejtuesin apo drejtuesen e drejtorisë së shërbimeve sociale në bashki. Pas përshkrimit të aktiviteteve do të paraqitet edhe kalendari me afatet përkatëse. Afatet, gjithashtu, do të dakordësohen me bashkinë.

1. Komunikimi me stafin e bashkisë dhe planifikimi i punës së bashku.

Konsulentja—pasi të prezantojë veten—do të ndajë planin e punës me drejtuesin/en e drejtorisë së shërbimeve sociale në bashki. Plani i punës do të diskutohet përmes telefonit—përpara takimit që do të zhvillohet në bashki (hapi 3).

2. Shqyrtimi i planit të mëparshëm social dhe materialeve të tjera rreth situatës socio-ekonomike në bashki.

Ky hap do të jetë i dobishëm për tu njohur me (a) karakteristikat lokale dhe prioritetet e vendosura në planin e mëparshëm social dhe (b) për të zhvilluar pyetje që do të udhëheqin hapat në vazhdim (hapat 3 & 4).

3. Takimi me drejtuesit dhe stafin e bashkisë si dhe aktorë të tjerë lokalë dhe rajonalë.

Qëllimi i vizitës së parë do të jetë të prezantohet procesi i hartimit të planit social. Po ashtu të diskutohen disa nga rezultatet e zbatimit të planit të mëparshëm si dhe shqetësime që dolën në pah gjatë zbatimit. Takimi do të organizohet me ndihmën e drejtorisë së shërbimeve sociale.

Drejtorit/es do t'i sugjerohet të ftojë në takim aktorë lokalë dhe rajonalë—për shembull, kryetarin/en e bashkisë, kryetarin/en e këshillit, nënkryetarët, këshilltarë, përfaqësues nga të gjitha drejtoritë e bashkisë, përfaqësues nga drejtori jashtë bashkisë por që lidhen me fusha të tilla si arsimit, shëndetësia, strehimi, punësimi, e kështu me radhë, përfaqësues të shoqërisë civile, si dhe përfaqësues të grupeve vulnerabël në komunitet (grupe që ka synuar të mbështesë plani i mëparshëm social apo edhe grupe të reja, të cilat kanë nevoja të paadresuara deri tani). Qëllimi është që takimi të jetë gjithëpërfshirës dhe të ketë përfaqësues nga grupe të ndryshme që do të ndikohen nga plani social si dhe do të merren me hartimin, zbatimin, monitorimin, dhe vlerësimin e tij. Drejtorit/es po ashtu do t'i sugjerohet që të informojë publikun përmes medias sociale apo formave të ndryshme të komunikimit që përdor bashkia.

Gjatë takimit të parë, një program i mundshëm është si më poshtë: Pas fjalës hyrëse të drejtuesit/es së bashkisë dhe përfaqësuesit/es të LNB-së, drejtuesi/ja e drejtorisë së shërbimeve sociale paraqet një përmbledhje të asaj çfarë u realizua përmes zbatimit të planit të mëparshëm social dhe shqetësime që kanë dalë në pah. Më tej, konsulentja paraqet disa shqetësime që lidhen me zbatimin e planeve vendore në nivel kombëtar si dhe paraqet hapat e punës në vazhdim. Gjatë hapit të fundit ftohen pjesëmarrësit të adresojnë pyetje dhe shqetësime.

4. Workshop 1.

Workshop-i i parë do të fokusohet në grumbullimin e të dhënave dhe diskutimin e planit social. Aktorë, të cilët janë përgjegjës për hartimin, zbatimin, monitorimin, dhe vlerësimin e planit social do të vijnë bashkë të diskutojnë prioritetet e planit të ri social—bazuar tek të dhënat që kanë grumbulluar drejtoritë e tyre dhe njohuritë e tyre të situatës në terren. Pjesëmarrësit do të punojnë në grupe të vogla dhe do të adresojnë një listë pyetjesh, të cilat do të përgatiten nga konsulentja. Diskutimet do të regjistrohen dhe informacioni do të përdoret gjatë hartimit të planit social.

Gjatë këtij hapi, konsulentja do të grumbullojë informacion rreth nevojave të stafit dhe aktorëve të tjerë lokalë—nëse kanë nevojë për tu thelluar në një temë specifike (për shembull si të zhvillojnë tregues për monitorimin e planit social). Workshop-i i dytë (hapi 5) do të fokusohet tek kjo temë.

5. Workshop 2.

Ky workshop do të fokusohet në nevojat që do të identifikohen gjatë hapit të mëparshëm (hapi 4). Qëllimi është forcimi i kapaciteteve të pjesëmarrësve në një fushë që është e rëndësishme për ta.

6. Workshop 3.

Gjatë këtij hapi, drejtorja e shërbimeve sociale do të prezantojë draftin e planit social—prezantim, i cili do të bëhet para grupit të aktorëve që u përfshinë në hapat 4 & 5. Prezantimi do të ndiqet nga sugjerime.

7. Komente dhe sugjerime me shkrim.

Konsulentja do të japë komente dhe sugjerime me shkrim me qëllim përmirësimin e planit social.

8. Finalizimi i planit social dhe diskutimi i hapave të mëtejshme.

Konsulentja do të mbështesë drejtorinë e shërbimeve sociale për të finalizuar planin si dhe do të diskutojnë bashkë hapat e mëtejshëm (si aprovimi i planit nga këshilli bashkiak dhe kërkimi i mbështetjes nga donatorë apo biznese lokale).

9. Mbështetje gjatë konsultimit të planit social.

Konsulentja do të mbështesë drejtorinë e shërbimeve sociale gjatë përgatitjes së prezantimit që do të përdoret për konsultim me aktorë lokalë. Ajo do të ofrojë këshilla për ta bërë konsultimin dhe komunikimin e planit social sa më efektiv.

10. Përfundimi dhe vlerësimi i procesit.

Për të vlerësuar procesin, konsulentja do të përdorë dy burime informacioni: (a) vëzhgimet e saj si dhe (b) një takim virtual që do të realizohet me personat që kanë qenë të përfshirë në proces.

Pjesëmarrësit në takimin virtual do të reflektojnë rreth eksperiencës dhe mësimave që nxorrën.

Kalendari i punës

Aktiviteti	Afati
1. Komunikimi me stafin e bashkisë dhe planifikimi i punës së bashku	26 qershor
2. Shqyrtimi i planit të mëparshëm social dhe materialeve të tjera rreth situatës socio-ekonomike në bashki	28 qershor
3. Takimi me drejtuesit dhe stafin e bashkisë si dhe aktorë të tjerë lokalë dhe rajonalë	7 korrik
4. Workshop 1	TBD
5. Workshop 2	TBD
6. Workshop 3	TBD
7. Dhënia e komenteve dhe sugjerimeve me shkrim	TBD
8. Finalizimi i planit social dhe diskutimi i hapave të mëtejshme	TBD
9. Mbështetje gjatë konsultimit të planit social	TBD
10. Përfundimi dhe vlerësimi i procesit	10 Dhjetor

Pjesëmarrja juaj është e rëndësishme për planifikimin e shërbimeve të qëndrueshme të mirëqenies sociale në bashkinë tonë

Jeni të lutur të merrni pjesë!

KRYETARI I BASHKISË
Alma HOXHA

Në mungesë dhe me porosi
SEKRETAR I PËRGJITHSHËM
Denisa DURRO